



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

---

**Njoftim Paraprak Përqendrimi**

Rasti: Përfitim kontrolli Banka Credins Sh.a - Sicred Sh.a – Shoqëria  
Administruese e Fondit të Pensionit Sicred Sh.a

Në datën 21 Janar 2015, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Kontratës për Shitje Aksionesh” e nënshkruar midis palëve: Banka Credins Sh.a (Blerësi) dhe Sicred Sh.a PLC (Shitësi), më datë 22 Dhjetor 2014, me objekt përfitim nga Banka Credins të paketës prej 75% të aksioneve të Shoqërisë Administruese së Fondit të Pensionit SICRED Sh.a të zotëruara nga SICRED Sh.a.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Banka Credins Sh.a:** ushtron veprimarinë si bankë e nivelit të dytë që prej vitit 2003. Ajo është e liçencuar dhe vepron në sektorin bankar dhe financiar , etj;
- **Sicred Sh.a :** shoqëri sigurimi private në Shqipëri e me kapital 100 % vendas e liçencuar për të vepruar në fushën e sigurimit të jetës;
- **Shoqëria Administruese e Fondit të Pensionit Sicred Sh.a:** ushtron veprimtarinë në administrimin e fondeve të pensionit vullnetar si dhe në mbledhjen dhe investimin e fondeve të pensionit vullnetar dhe kryerjen e pagesave të pensionit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 10, pika 1, shkronja b), 12, pika 1) dhe 2 , pika 1) shkronja a) të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**